

## Kushtet e shërbimit

### E përgjithshme

Web4jobs realizohet si pjesë e projektit WeB4YES (Western Balkan Civil Society Organizations for Youth Employment Support) është mbështetur në kuadër të Programit të Mediave dhe Shoqërisë Civile 2016 - 2017 Konsolidimi i Rrjeteve Tematike Rajonale të Organizatave të Shoqërisë Civile nga Komisioni Evropian. Ky projekt përfaqëson një iniciativë rajonale e hartuar për të ofruar qasje inovative ndër-sektoriale dhe për t'u ofruar të rinjve të papunë të rajonit të Ballkanit Perëndimor mundësi për zgjerim punësim dhe për të u punësuar. Projekti është hartuar për të adresuar sfidat ekzistuese të bashkëpunimit të pamjaftueshëm midis aktorëve të shoqërisë civile dhe autoriteteve publike në Ballkanin Perëndimor në proceset e politikave dhe vendimmarrjen drejt procesit të reformës lidhur me papunësinë e të rinjve.

Në vijim ne do të shpjegojmë kushtet e përdorimit të shërbimeve t aplikacionit:

### Pranimi i kushteve të shërbimit

Duke përdorur informacionin, veglat, veçoritë dhe funksionalitetin e vendosur në WEB4JOBS, nëpërmjet API të kësaj ueb faqeje ose nëpërmjet ndonjë aplikacioni ose faqeje tjetër të ndërfaqeve me web4jobs, ju pranoni të jeni një “Vizitor” (që do të thotë që ju thjesht kërkonti faqen e internetit WEB4JOBS). Termi “ju” ose “Përdorues” i referohet një Vizitori në internet.

Me rastin e hyrjes në faqen WEB4JOBS, ju pajtoheni të pranoni kushtet e shërbimit aktual, sipas ligjeve dhe rregulloreve të zbatueshme, si dhe pajtoheni se jeni përgjegjës për pajtueshmëri me çfarëdo ligji të zbatueshëm vendor. Nëse nuk pajtoheni, ju mund të mos vizitoni më faqen.

### E drejta autoriale dhe përdorimi i materialeve

Të gjitha përmbajtjet në WEB4JOBS, si tekstet, grafikat, logot, ikonat e butonave, imazhet, klipet audio, shkarkimet digjitale, janë e drejtë autoriale e WEB4JOBS të mbrojtur me ligjet e aplikueshme vendore autoriale.

Të gjitha përmbajtjet e qasshme në këtë faqe, janë për informim të përdoruesve të internetit që pranojnë dhe/ose marrin shërbime të komunikimeve elektronike në Kosovë. Lejohet përdorimi i materialeve publike për qëllime edukative dhe assesi për qëllime komerciale. Dhënia e lejes nuk nënkupton bartje të titullit, dhe nën këtë leje ju nuk mund të:

- modifikoni, përvetësoni ose kopjoni materialet;
- përdorni ose riprodhoni materialet të pjesshme ose të plota, pa pëlqim paraprak dhe citim të burimit;
- përdorni materialet në çfarëdo forme digjitale ose tradicionale të transmetuar, printuar, publikuar ose shtypur për qëllime të tërthorta ose direkte komercial ose të keqpërdorohen apo abuzohet me informatat e cilësdo përmbajtte (tekstuale, vizuale, audio apo softuerike) të kësaj faqeje.

## Publikimi i përmbajtjeve dhe informacioneve

Kjo faqe pasurohet kohë pas kohe me përmbajtje (lajme, resurse, njoftime për organizimin e ngjarjeve, analiza, infografikone) varësisht prej dinamikës së aktiviteteve të planifikuara. Informacionet dhe shërbimet e ofruara për përdoruesit e kësaj faqe në internet, janë FALAS. Burimet e informacioneve mblidhen nga kanale të hapura ose përmes punës së stafit me leje paraprake. Atëherë kur është planifikuar me projekt, ne mbledhim të dhëna në lidhje me objektivat kërkimore (hulumtuese). Informacionet mund të na ofrohet nga vetë individët, nga burime të disponueshme në publik, nga palë të treta dhe gjithmonë duke respektuar standardet më të larta etike dhe profesionale.

## Mohimi nga përgjegjësia

Shërbimet e WEB4JOBS, dhe përmbajtjet që mund të të shkarkohen dhe janë të qasshme për përdoruesit në internet, ofrohen dhe menaxhohen nga LENS dhe partnerwt e Web4Yes. JU shprehimisht jeni dakord që përdorimi juaj i WEB4JOBS, shërbimeve të saja, janë përgjegjësi e vetme e juaja. Për faktin e ndjeshmërisë së të dhënave digjitale, JU jeni dakord dhe jeni të vetëdijshëm mbi mënyrën e përdorimit dhe dëmet që mund të shfaqen ose shkaktohen si rezultat i rrugëtimit digjital të të dhënave ose prej aplikacioneve shkarkuese ose përmes pajisjeve të përdorura siç janë shfletuesit apo sistemet operative të kompjuterëve.

Do të behën përpjekje maksimale për të parandaluar çdo ndërhyrje ose nga viruset ose komponentët e tjera të dëmshme në aplikacion, në çdo shërbim, servera, ose emailat e dërguara.

Pavarësisht nga më sipër, kjo faqe pranon se është në përputhje me standardet më të larta etike dhe profesionale në organizatë në mbrojtjen dhe ruajtjen e të dhënave përmes rrjetit të saj.

## Saktësia e materialeve

Për arsyetimin se kjo faqe është si rezultat i aktiviteteve të projektit “Web4Yes”, nuk mund të garantojë në kohë afatgjate se materialet e publikuara të jenë të përditësuara ose aktuale. Ndryshimet e materialeve të paraqitura në internet mund t’i bëjmë në çdo kohë dhe pa lajmërim. Materialet e shfaqura në adresë të internetit mund të përfshijnë gabime teknike, tipografike, ose fotografike. Mirëpresim angazhimin e publikut në raportimin në aë adresën tonë të lëshimeve të tilla.

## Lidhjet (Hyperlinks)

Shërbimi mund të ofrojë, lidhje me ueb faqe ose burime të tjera. Duke qenë se WEB4JOBS nuk ka kontroll mbi faqet dhe burimet e tilla, ju pranoni dhe pajtoheni që WEB4JOBS nuk është përgjegjës për disponueshmërinë e faqeve ose burimeve të tilla të jashtme, dhe nuk miraton dhe nuk është përgjegjës për çdo përmbajtje, reklamim, produkte ose produkte të tjera materiale nga këto burime. Ju gjithashtu pranoni dhe pajtoheni që WEB4JOBS nuk do të jetë përgjegjës i drejtpërdrejt ose tërthorazi, për çdo dëm apo humbje të shkaktuar ose të dyshuar të shkaktuar nga ose në lidhje me përdorimin ose mbështetjen në ndonjë përmbajtje të tillë.

## Privatësia dhe Cookies.

Shpjegimet e praktikave të grumbullimit dhe përpunimit të të dhënave, privatësisë, dhe përdorimit të Cookies mund të gjeni në faqen për privatësi.

## Ligjet e aplikueshme

Këto kushte të përdorimit interpretohen në pajtim me ligjet e vendeve respektive ku aplikohet projekti dhe ju i nënshtroheni pakthyeshem jurisdikcionit ekskluziv të gjykatave në atë shtet ose vendndodhje.

## Modifikimet e kushteve të shërbimeve

Kushtet dhe mënyrat e përdorimit të shërbimeve të kësaj faqeje mund të rishikohen dhe ndryshohen. Kjo mund të bëhet në çdo kohë pa lajmërim dhe do të shfaqet koha, data dhe natyra ku tregohen qartë në këtë dokument për rregullat e reja.

## Kontakti me ne

Belgrade Open School

**SERBIA**

Address:

Belgrade Open School

Masarikova 5/16

11000 Belgrade

Serbia

Phone: +381 11 30 65 800

Fax: +381 11 36 13 112

Email: bos@bos.rs

Association for Democratic Prosperity ZID

**MONTE NEGRO**

Adress:

Gojka Radonjića 32

P fah 370

Podgorica

Crna Gora

+382 20 207 130

+382 20 207 131

+382 67 210 848

adp.zid@gmail.com

Beyond Barriers Association

**ALBANIA**

Adress:

Rruga Don Bosko, Blloku Edil-AL, Kulla 4, Kati 8, Ap 52

Tirana, Albania

+355 4 480 6136

office@beyondbarriers.org

Institute for Youth Development KULT

Bosnia and Herzegovina

Adress:

Ul. 4. viteške brigade 34-36

BA-71210 Ilidža

Tel.: +387 33 778 778

Faks: +387 33 778 779

kult@mladi.org

International Center Olof Palme

Address:

Sveavägen 68, 5 tr

Stockholm

Sweden

+46 (08) 677 57 70

info@palmecenter.se

LENS

Kosovo

Adress: Sylejman Vokshi, 25 2nd floor, Nr. 6

10000 Prishtinë

+381 38 74 81 50

info@ngolens.org

National Youth Council of Macedonia

Macedonia

Adress:

NYCM

st. Aminta Treti 29/1-3, 1000 Skopje

info@nms.org.mk

+389 78 350 531

Macedonia

WEB4YES PROJECT

Address:

Belgrade Open School

Masarikova 5/16

11000 Belgrade

Serbia

Phone: +381 11 30 65 800

Fax: +381 11 36 13 112

Email: [web4yes@bos.rs](mailto:web4yes@bos.rs)

Nëse keni ndonjë pyetje lidhur me kushtet e shërbimit ose ndonjë sqarim, ju lutem na kontaktoni në: [web4yes@bos.rs](mailto:web4yes@bos.rs) apo [info@web4jobs.com](mailto:info@web4jobs.com)